



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE



United Nations  
ALBANIA



Empowered lives.  
Resilient nations.

# ARSIMI



Leave  
No One  
Behind

@ UNDP


Tiranë, Korrik 2018

Autore: Sidita Fortuzi

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij udhëzuesi për qëllime përfitimi

Ky udhëzues u realizua përmes programit “Askush të mos mbetet pas”, financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim, SDC, dhe zbatuar nga UNDP.

Mendimet e shprehura në këtë udhëzues u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP.



**Seksioni “Arsimi” përmbledh legjislacionin që rregullon arsimimin e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë seksion gjendet informacion mbi:**

Ligj Nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

Fletore Zyrtare Nr.87, datë 21.06.2012 (botuar 26.07.2012)

[http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/arsim/Ligj%20nr.69\\_%202012%20per%20sistemin%20arsimor%20parauniversitar.pdf](http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/arsim/Ligj%20nr.69_%202012%20per%20sistemin%20arsimor%20parauniversitar.pdf)

Urdhër Nr. 344, datë 19.8.2013 Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social

Fletore Zyrtare Nr. 156, datë 19.08.2013 (botuar 19.09.2013)

[http://www.vet.al/files/ligje%20etj/2013\\_2014/urdher-344-sherbimi-psiko-social.pdf](http://www.vet.al/files/ligje%20etj/2013_2014/urdher-344-sherbimi-psiko-social.pdf)

Udhëzim Nr. 38, datë 07.10.2014 Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar

Fletore Zyrtare Nr. 179, datë 07.10.2014 (botuar 24.11.2014)

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/179-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/179-2014.pdf)

Urdhër nr. 343, datë 19.8.2013 për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar

Fletore Zyrtare 158, datë 19.08.2013 (botuar 26.09.2013)

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2013/PDF-2013/158-2013.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/158-2013.pdf)

Vendim Nr. 269, datë 29.3.2017 për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit

Fletore Zyrtare Nr. 70, datë 29.03.2017, (botuar 05.04.2017)

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%2070/VKM%20nr.%20269,%20date%2029.3.2017.pdf>

Plani Kombëtar i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2020

Fletore Zyrtare Nr. 124, 7 Korrik 2016

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf)

**Çfarë thotë Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara mbi arsimin?**

Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për arsim. Me qëllim realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë do të garantojnë një sistem arsimor përfshirës në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe arsimin gjatë gjithë jetës me synim:

- (a) Zhvillimin e plotë të potencialit njerëzor dhe ndjenjës së dinjitetit dhe vetëvlerësimit, fuqizimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor;
  - (b) Zhvillimin nga ana e personave me aftësi të kufizuar të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së tyre, si edhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë;
  - (c) Mundësimin e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë.
2. Gjatë realizimit të kësaj të drejte, Shtetet Palë do të garantojnë që:
- (a) Personat me aftësi të kufizuar të mos jenë të përjashtuar nga sistemi i arsimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar dhe që fëmijët me aftësi të kufizuar të mos jenë të përjashtuar nga arsimimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimit mesëm, për shkak të aftësisë së kufizuar;
  - (b) Personat me aftësi të kufizuar mund të kenë akses në arsimin fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arësimin e mesëm njësoj si të gjithë fëmijët e tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;
  - (c) Sigurohet akomodimi i arësyeshëm i kërkesave individuale;
  - (d) Personat me aftësi të kufizuar marrin mbështetjen e kërkuar, brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm për të mundësuar arsimimin e duhur të tyre.
  - (e) Sigurohen masa mbështetëse efikase dhe të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në përputhje me qëllimin për përfshirjen e tyre të plotë.
3. Shtetet Palë do të bëjnë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të mësojnë aftësi për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim dhe si pjestarë të komunitetit. Për këtë qëllim Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura, duke përfshirë:
- (a) Lehtësimin e të mësuarit të Braille, shkrimeve alternative, mënyrave augmentative/njohese dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, aftësive të orientimit dhe lëvizshmërisë dhe lehtësimin e mbështetjes dhe kujdesit nga moshatarët;
  - (b) Lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe nxitjen e identitetit lingvistik të personave që nuk dëgjojnë;
  - (c) të sigurohen që arsimimi i individëve, dhe në veçanti i fëmijëve, të cilët janë të verbër, nuk dëgjojnë, apo që nuk degjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë të jepet në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror të tij/saj.
4. Me qëllim që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për punësimin e mësuesëve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuar, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille, dhe të trainojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore. Trainime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohese dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar.
5. Shtetet Palë do të garantojnë që personat me aftësi të kufizuar të jenë në gjendje të kenë akses në arsimin e lartë, trainime profesionale, arsimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Për këtë qëllim, Shtetet Palë do të garantojnë ofrimin e akomodimit të arësyeshëm për personat me aftësi të kufizuar.

## **Ligj “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**

### ***Cili është qëllimi i këtij ligji?***

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

### ***Si i mbron ky ligj personat me aftësi të kufizuara?***

Ligji siguron që çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Njësitë vendore, sipas këtij ligji janë veshur me disa përgjegjësi në fushën e arsimit. Kështu, këto njësi të qeverisjes vendore kanë për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike.

### ***Çfarë synon arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas këtij ligji?***

Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.

### ***A mund të arsimohen në institucione të specializuara nxënësit me aftësi të kufizuara?***

Po, por përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.

Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.

### ***Kush vendos se cilën formë arsimimi duhet të ndjekë fëmija me aftësi të kufizuara?***

Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar por në fund të procesit prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

### **Po në shtëpi a mund të arsimohen fëmijët me aftësi të kufizuara?**

Njësia arsimore vendore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundën të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.

### **Si komunikojnë nxënësit që nuk dëgjojnë, flasin e shikojnë?**

Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail.

A ka program të personalizuar për nxënësit me aftësi të kufizuara?

Po. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënësve të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësve.

### **Çfarë parashikimesh ka ligji për mësuesin mbështetës?**

Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.

### **Cilat janë disa nga detyrat e njësive vendore?**

Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

- a) ndërtimi dhe rikonstrukcioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
- b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
- c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
- ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

\* Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

Në mbështetje të ligjit janë këto vendime:

## **Urdhër “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”**

### **Cili është qëllimi i këtij urdhri?**

Drejtoria Arsimore Rajonale ose Zyra Arsimore Rajonale ngarkohen me detyrën për të ngritur Njësinë e Shërbimit Psiko-Social.

Shërbimi Psiko-Social vlerëson gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të të nxënësve ose të sjelljes dhe, në bashkëpunim me mësues e drejtues të institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.

## Udhëzim "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar

### ***Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë një mësues ndihmës?***

Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore publike duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) Të jetë pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit.
- b) Të ketë kryer trajnime të specializuara për trajtimin dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë, që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar.

### ***Çfarë detyrash ka mësuesi mbështetës?***

Mësuesi ndihmës jep ndihmesën e tij për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik të nxënësve me aftësi të kufizuara (AK).

Mësuesi ndihmës bashkëpunon me mësuesin ose mësuesit lëndor, mësuesin kujdestar dhe psikologun/punonjës social për gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK në institucionet arsimore të zakonshme.

Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin e nxënësit me AK/mësuesit lëndor dhe prindërit, hartojnë dhe vënë në jetë programin edukativ individual (PEI) të nxënësit, të miratuar nga komisioni i shkollës për fëmijët me AK.

### ***Kush përcakton nevojën për mësues mbështetës?***

Komisioni vlerësues i ngritur pranë njësisë arsimore vendore (DAR/ZA-ve), mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur për çdo nxënës nga institucionet arsimore, vlerëson shkallën e paaftësisë së nxënësit dhe përcakton:

- a) nevojën për mësuesin ndihmës në klasë;
- b) nevojën për mësues ndihmës në shtëpi;
- c) numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me aftësi të kufizuar dhe e shënon atë në dosjen e vlerësimit;
- d) pas çdo vlerësimi (një herë në vit) bën rivlerësim të nevojës së nxënësit për mësues ndihmës.

## Dispozitat Normative 2013

Sipas Dispozitave Normative ngrihen dy komisionet: Komisioni multidisiplinar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Komisioni në institucionin arsimor.

### ***Kush ka për detyrë të ngrejë komisionin pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale ose Zyrës Arsimore?***

DAR/ZA ngre komisionin multidisiplinar;

### ***Cila duhet të jetë përbërja e këtij komisioni?***

Një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

### ***Kush është kryetari i komisionit?***

Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

### ***Cilat janë detyrat e komisionit?***

Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij.

Komisioni:

- a) njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës
- b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas;
- ç) sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;
- d) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;
- dh) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka.

Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit mbështetet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe funksionimit të aftësisë së kufizuar (standarde të Organizatës Botërore të Shëndetësisë).

Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës, dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij.

Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK). Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale. Komisioni pranë DAR/ZA-së udhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësit me AK.

Komisioni mban dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe përditëson ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin në institucionin arsimor.

### ***Sa herë mblidhet komisioni dhe kur?***

Komisioni mblidhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor.

### ***Çfarë detyre ka sipas ligjit drejtori?***

Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t'i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.



### **Çfarë detyrash ka prindi?**

Prindi drejton kërkesë pranë komisionit për vlerësimin e fëmijës.

Prindi i paraqet komisionit pranë DAR/ZA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, kur fëmija është vlerësuar nga ky Komision Mjekësor.

### **Cilat janë detyrat e DAR/ZA?**

DAR/ZA siguron kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.

### **Po komisioni pranë institucionit arsimor si funksionon?**

Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me AK.

### **Cila është përberja e komisionit?**

Tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.

Në komision merr pjesë, të paktën një nga mësuesit e nxënësit me AK dhe mësuesi ndihmës (kur ka).

### **Kush është kryetari i këtij komisioni?**

Kryetar i komisionit është punonjësi i shërbimit psiko-social.

### **Cilat janë detyrat e komisionit?**

Duke u bazuar në vlerësimin e komisionit pranë DAR/ZA, komisioni:

Udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton;

Ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve;

Ndjek ecurinë e fëmijëve me AK;

Paraqet pranë komisionit të DAR/ZA-së, raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni pranë DAR/ZA-së.

\*Anëtarët e komisionit pranë DAR/ZA-së dhe në institucionit arsimor, mësuesit dhe mësuesit ndihmës, që punojnë me fëmijë me AK, nuk kanë të drejtë të japin të dhënat personale të këtyre fëmijëve personave të paautorizuar nga komisioni pranë DAR/ZA-së/drejtori i institucionit arsimor.

**Vendim “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”**

### **Çfarë përcakton ky vendim?**

Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, (të ndryshuar), ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga

njësitë e vetëqeverisjes vendore përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit kur ata janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në institucionet publike të arsimit të lartë.

Këta studentë duhet të paraqesin dokumentacionin vërtetues për statusin e tyre ligjor para Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë i cili shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor listën e studentëve të kategorive të individëve.

\*Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve.

\*Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

## **Plani Kombëtar i Veprimit për PAK, arsimi**

### ***Çfarë ka marrë përsipër Plani Kombëtar i Veprimit për PAK në lidhje me arsimin?***

Qeveria merr përsipër të sigurojë arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Të përmirësojë cilësinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara.

Të transformojë shkollat e specializuara në qendra burimore.



